



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 776/4 Prot.

Tiranë, më 01.04.2021

VENDIM

Nr. 20, datë 01.04.2021

**PËR RIHAPJEN E PROCESIT PËR DORËZIMIN E DOKUMENTACIONIT PËR  
STUDENTËT E CIKLIT TË DYTË, PËR TË PËRFITUAR ULJE (50%) TË  
TARIFËS SË SHKOLLIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2020-2021, NË  
UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË**

Në mbështetje të ligjit, nr.80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet publike të arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë", neni 2, 3 dhe 4, VKM -ja nr.780, datë 26.12.2018 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e uljes së tarifës vjetore të studimit, në programet e ciklit të dytë të studimit në institucionet e arsimit të lartë", vendimet e Bordit të Administrimit nr.57, datë 20.12.2019, "Për miratimin e dokumentacionit që duhet të paraqitet nga studentët e ciklit të dytë të studimeve, për reduktim të tarifës së shkollimit, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë" dhe nr.36, datë 28.09.2020, "Për miratimin e një ndryshimi në dokumentacionin për ulje të tarifës së shkollimit që duhet të paraqitet nga studentët e ciklit të dytë të studimeve, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë", vendimin nr.7, datë 03.03.2021 të Dekanatit të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, materialin e Administratorit të UMT-së nr.470/5 prot, datë 24.03.2021 "Mbi rihapjen e procesit për përjashtim nga tarifa për studentët e ciklit të dytë", Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 01.04.2021,

**VENDOSI:**

1. Të pranojë kërkesën e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike për rihapje të procesit për dorëzimin e aplikimeve dhe dokumentacionit justifikues, për studentët e ciklit të dytë, për të përfituar ulje 50% të tarifës së shkollimit për vitin akademik 2020-2021.
2. Procesi i aplikimeve të jetë nga data 21.04.2021 deri në datën 05.05.2021.
3. Dokumentacioni justifikues për plotësimin e kriterëve (vendimet e KMCAJ-së, ndihma ekonomike e plotë apo e pjesshme, statusi i jetimit ose të verbërit, vendimet gjyqësore për humbje të kujdestarisë prindërore etj), duhet të jenë përfituar para muajit dhjetor 2020.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ngarkohet Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, për zbatimin dhe publikimin e tij në faqen zyrtare të Institucionit.

**KRYETARI  
FLORIAN TOTI**

